



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Floring" Sh.P.K. të datës 21.08.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 10.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 17.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës në lagjen Kalabria" me nr. të prokurimit 616-23-6340-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Floring" Sh.P.K. e datës 21.08.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 10.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 17.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës në lagjen Kalabria" me nr. të prokurimit 616-23-6340-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Floring" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Floring" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 21.08.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës 10.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 17.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës në lagjen Kalabria" me nr. të prokurimit 616-23-6340-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë se duhet të largohen nga dosja e tenderit kërkesat e cituara si në vijim:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1	Kapaciteti teknik dhe profesional	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
	&	Nje Menaxher i Projektit -	CV-a, Diploma, Certifikata, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit.
	9.2	Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë - min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit (drejtimi konstruktiv). Të jetë i certifikuar për mbrotje dhe siguri në punë.	
		- Një (1) Saldues të certifikuar sipas EN ISO 9606.	Certifikata, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.
		- Dy (2) Saldues të certifikuar sipas EN 13067.	Certifikata, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt
	- Min. 15 punëtorë, të certifikuar për mbrotje dhe siguri në punë, prej të cilëve min. 3 të jenë teknik të ndërtimtarisë	Certifikata, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.	
	ISO 9001 - Menaxhimi i Cilësisë	Dëshmia - kopjet e certifikatave	

Aneksi 8 Lista e Pajisjeve

Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar (cope)
Mini eskavator 1 - 1.5T	2
Aparat për testimin e gypave EN 805/W400	1

Konkretisht pretendimet ankimore të parashtruesit janë formuluar si në vijim: *“duke u bazuar në njoftimin e kontratës me datë 10.07.2023 kërkojmë nga AK që t’i largoj këto kërkesa diskriminuese pasi që në njoftimin e parë për kontratë ishin kriteret të cilat u mundësonin kompanive të tjera ofertimin ndërsa ju me datë 04.08.2023 në formularin e korigjimit keni bërë shumë ndryshime në dosje të tenderit dhe e keni vështirësuar mundësinë për ofertim...”*.

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 24.08.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Fillimisht duhet nenin 60 paragrafin 60.3 nënparagrafët f) dhe h) të RRPP ku përcaktohet se kërkesa për rishqyrtim ndër të tjera duhet që të *“f). Përshkruan rrethanat faktike që përbëjnë apo prodhojnë shkeljen e pretenduar”* si dhe *“h). Përshkruan se si është shkaktuar shkelja e pretenduar, apo kërcënon të shkaktoj dëm material parashtruesit të ankesës në rastet kur parashtruesi i ankesës përfshin një padi për kompensim”*.

Nga analizimi i formulimit të pretendimeve ankimore në formën siç janë parashtruar në kërkesën për rishqyrtim, askund nuk janë përshkruar rrethanat faktike që përbëjnë apo prodhojnë shkeljen e pretenduar dhe aq më pak përshkruajnë se si është shkaktuar shkelja e pretenduar apo kërcënon që t’i shkaktoj dëm material parashtruesit në kuptim të nenit 60 paragrafit 60.3 nënparagrafëve f) dhe h) të RRPP. Konstatimi i vetëm i

parashtruesit është se këto kërkesa janë diskriminuese mirëpo nuk paraqet edhe argumentet sipas të cilave këto kërkesa të dosjes së tenderit qenkan diskriminuese sipas parashtruesit. Sipas dispozitave të cituara më sipër nga RRPP, një pretendim i tillë ankimor do duhej të shtjellonte deri në detaje argumentet sipas të cilave njëra ose kërkesa tjetër është diskriminuese/favorizuese. Këto argumente mungojnë në pretendimet ankimore sikurse janë formuluar nga parashtruesi.

Sidoqoftë, duhet theksuar se aktiviteti përkatës i prokurimit ka të bëjë me ndërtimin e shkollës në një lagjen Kalabria të Komunës së Prishtinës. Ky projekt si i tillë është shumë i rëndësishëm pasi që në lagjen Kalabria aktualisht nuk ka asnjë shkollë përkundër faktit se lokaliteti në atë zonë është mjaft i madh. Pra ky projekt si i tillë është jetik jo vetëm për lagjen Kalabria por Komunën e Prishtinës. Në anën tjetër nuk bëhet fjalë për objekt të zakonshëm mirëpo fjala është për ndërtimin e një shkolle për nxënës. Rrjedhimisht cilësia e ndërtimit duhet të jetë jashtëzakonisht e lartë dhe në përputhje me nevojat/specifikat e nxënësve nga të cilët do të shfrytëzohet kjo shkollë. Definitivisht autoriteti kontraktues është shumë i interesuar që ky projekt të realizohet në mënyrë shumë profesionale dhe në përputhje me standardet e fundit ndërkombëtare. Për këtë qëllim në dosjen e tenderit janë vendosur edhe kërkesat minimale që janë të domosdoshme për realizimin e këtij projekti me sukses. Ajo që tërheq më shumë vëmendjen te kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me faktin se pretendimet ankimore janë drejtuar kundër kërkesave më bazike në dosjen e tenderit siç është kërkesa për saldues, inxhinier të ndërtimtarisë, mini eskavator, aparat për testimin e gypave, etj. Pra kërkesat që i ka kundërshtuar parashtruesi me një fjalë janë të domosdoshme për ndërtimin e një shkolle sikurse në rastin konkret. Pra është për t'u quditur kërkesa e parashtruesit për të larguar këto kërkesa pa dhënë asnjë sqarim logjik se si parashtruesi e ka paramenduar realizimin e një projekti kaq të rëndësishëm pa i përmbushur këto kërkesa kaq bazike.

Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Në anën tjetër përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në kontekst të dispozitave si më sipër, njësia kërkuese dhe zyrtari i përgjegjës i prokurimit së bashku kanë analizuar pretendimet ankimore dhe kanë gjetur se nuk ekzistojnë argumente sipas të cilave do të duhej të largoheshin nga dosja e tenderit kërkesat për të cilat pretendohet nga parashtruesi. Përkundrazi në këtë rast është konstatuar se këto kërkesa janë themelore dhe si të tilla të domosdoshme për realizimin e një projekti të tillë duke marrë parasysh edhe natyrën, specifikat dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit.

Sa i përket pjesës së pretendimit ankimor se autoriteti kontraktues ka publikuar një njoftim për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, ky veprim është realizuar në përputhje të plotë me LPP dhe RRPP (fakt që nuk kontestohet as nga parashtruesi).

Vlen të shtohet se korigjimet e tilla janë bërë për shkak se autoriteti kontraktues duke trajtuar kërkesat për sqarime nga tenderuesit ka evidentuar disa gabime që kanë qenë në dosjen e tenderit dhe pikërisht këto gabime i ka përmisuar. Në këtë mënyrë autoriteti kontraktues është siguruar se ky aktivitet i prokurimit do të zhvillohet në përputhje të plotë me parimet e LPP për mos diskriminim/favorizim por edhe me parimet për ekonomikitet dhe efikasitet në kuptim të nenit 6 dhe 7 të LPP lidhur me nenin 1, et. al.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin b) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 24.08.2023

Visar SHEHU
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.